

PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.D.
Nr./No./Br. 01-719/2026
Data/Date/Datum 17-04-2026
PRISHTINE-PRISTINA-PRISTINA



Ndërmarrja Publike Qendrore

Posta e Kosovës Sh. A.

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), ,nenit 33 të Statutit të ndërmarrjes nr.01-1038/25 të datës 18.06.2025, Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së punës 01-3060/24 e datës 31.12.2024 dhe plotësimit të Rregullores me nr 01-932/2025 të datës 30.05.2025, si dhe vendimit 01-649/26 te datës 08.04.2026 Kryeshefja Ekzekutive e Postës së Kosovës Sh.A., shpall këtë:

KONKURS I BRENDSHËM PER VEND PUNE NË POSTËN E KOSOVËS Sh.A.

Titulli i pozitës:

Administrator në përkrahjen e rrjetit të TI

Përshkrimi: Posta e Kosovës Sh.A. është duke bërë përpjekje për të zhvilluar biznesin sipas përvojave më moderne të shërbimeve postare dhe komerciale, për t'i arritur standardet ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve postare dhe komerciale. Në këtë aspekt, PK Sh.A. ofron mundësi të barabartë punësimi të profesionistëve që synojnë të jenë pjesë e zhvillimit të biznesit dhe kompetencave të Korporatës, në përputhje me metodat dhe praktikat moderne.

Kohëzgjatja e kontratës: Është konform ligjeve ne fuqi dhe Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së punës për punonjësit e PK.Sh.A me nr 01-3060/24.

Aplikimi: Aplikacionet për punësim dhe Deklaratën nën Betim mund të merren online; www.postakosoves.com dhe së bashku me dëshmitë përkatëse të dërgohen me Postë elektronike ne adresën hr.konkursi@postakosoves.com , deri në afatin e paraparë për aplikim me shenjë "PËR KONKURS", duke e cekur titullin e vendit të punës për të cilin aplikoni.

Komunikimi:

Komunikimi në mes të ndërmarrjes dhe kandidatit gjatë gjithë procedurës do të bëhet nëpërmjet e-mailit të cilin fillimisht ka aplikuar apo ndonjë e-maili që kandidati e njofton paraprakisht ndërmarrjen për ndryshimin e e-mailit.

Pozita: Administrator në përkrahjen e rrjetit të TI

Mbikëqyres: Menaxheri i TI &SI

Grada : G11

Paga: 1,077 € bruto

Vendi i punës : Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore te punës:

- Projekton, implementon dhe mirëmban topologjinë e rrjetit në nivelet Layer 2 dhe Layer 3, në përputhje me nevojat operative, standardet e sigurisë dhe politikat e ndërmarrjes.
- Konfiguron dhe administron VLAN, Access/Trunk Ports, Spanning Tree Protocol (STP) dhe EtherChannel.
- Implementon dhe menaxhon routing statik dhe protokolle dinamike të rutimit (si p.sh. OSPF, EIGRP, BGP).
- Administron firewall-et dhe politikat e sigurisë (p.sh. Cisco Firepower), duke siguruar segmentim të rrjetit dhe kontroll efikas të trafikut.
- Harton dhe zbaton politika dhe procedura të sigurisë për mbrojtjen e infrastrukturës rrjetore dhe të dhënave.
- Monitoron performancën e rrjetit, identifikon rreziqe dhe zbaton masa për përmirësim të vazhdueshëm dhe zgjidhje proaktive të problemeve.
- Zhvillon, mirëmban dhe përditëson dokumentacionin teknik të rrjetit.
- Bashkëpunon ngushtë me ekipet e sistemeve, aplikacioneve dhe mbështetjes teknike, për të garantuar integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës.
- Udhëheq dhe mentoron administratorët e tjerë të rrjetit, duke ofruar mbështetje profesionale dhe duke promovuar praktikat më të mira të inxhinierisë së rrjeteve.
- Kryen detyra të tjera në përputhje me natyrën e punës, ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe sipas kërkesës së eprorëve në DTISI.

Kualifikimi, përvoja dhe aftësitë:

- Diplomë universitare (Bachelor) në fushën e shkencave kompjuterike ose fushë tjetër nivelit Bachelor, ose edukim i avancuar, si dhe njohuri të dëshmuara në nivel CCNP, të fituara përmes trajnimeve profesionale dhe përvojës praktike.
- Përvojë pune minimum 5 (pesë) vite në administrimin dhe menaxhimin e rrjeteve enterprise.
- Njohuri të thelluara në Layer 2 networking (VLAN, Trunking, STP, EtherChannel).
- Ekspertizë në routing statik dhe dinamik (OSPF, EIGRP, BGP).

- Përvojë praktike me Cisco Firepower, duke përfshirë konfigurimin, zbatimin e politikave të sigurisë dhe troubleshooting.
- Aftësi të forta analitike, menaxhuese dhe ndërpersonale.
- Njohuri të avancuara në dokumentimin teknik dhe automatizimin e konfigurimeve rrjetore.

Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidati, duhet t'i dorëzoj këto dokumente:

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e PK-së <https://postakosoves.com/publikime/mundesi-punesimi/>);
2. CV-ja (Biografia),
3. Letër motivimi,
4. Dëshminë e shkollimit (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i),
5. Dëshmi përkatëse mbi përvojën e punës sipas vërtetimeve përkatëse (Përvoja e punës të dëshmohet edhe nga Trusti Pensional);
6. Kopja e letërnjoftimit apo pasaportës valide;
7. Certifikatën mbi dënimin penal nga Gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale (certifikata jo më e vjetër se 6 muaj).

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Brenda 10 ditëve nga afati i përmbylljes së konkursit bëhet verifikimi i Aplikacioneve dhe përpilohet lista e kandidatëve mbi plotësimin /mosplotësimin e kriterëve të konkursit.

Afati i ankesave për verifikimin e aplikacioneve 3 ditë.

Shqyrtimi i ankesave ndaj vendimit për verifikimin e aplikacioneve 5 ditë

Njoftimi mbi mbajtjen e testit dhe intervistave 48 orë para mbajtjes.

Procedura e vlerësimit përmbajn gjithsejt 100 pikë, me kalueshmërinë e testit me shkrim prej së paku 55 pikë. Pikët e testit me shkrim ,mblidhen me pikët e testit me gojë dhe kandidati me më së shumti pikë cilësohet i suksesshëm .

Vendimi i intervistimit për kandidatin ma të suksesshëm ,5 ditë pas mbajtjes së intervistave

-Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Vërejtje: Dokumentacioni i dërguar për këtë konkurs duhet të jetë kopje (përveç certifikatës nën hetime të lëshuar nga Gjykata që me rastin e intervistës duhet të sjellët origjinal si dhe kopja e diplomës së shkollimit duhet të jetë e noterizuar) sepse të njëjta nuk i kthehen kandidatëve.

Informata të përgjithshme:

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

Konkursi është i brendshëm nga data 17.04.2026 dhe përfundon më datë 27.04.2026 në ora 16:00.

Kandidatët me dokumentacion të mangët, të paplotësuar dhe jo adekuat do të refuzohen.

Kryeshefja Ekzekutive e PK SH.A.

Nora Rraçi

